



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 72, Datë 13.03.2023

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “SUN AVENUE” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME
KAPACITET TË INSTALUAR 2 MW, NË POVELÇË, BASHKIA FIER**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1, gërma “a” dhe nenit 13 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 13.03.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 136/8 prot., datë 07.03.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë “SUN AVENUE” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, në Povelçë, Bashkia Fier”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 3, datë 10.01.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “SUN AVENUE” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 11.01.2023 dhe 12.01.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 20.01.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla.
- Për shkak të kohës së pamjaftueshme për shqyrtimin e dokumentacionit plotësues të depozituar nga ana e shoqërisë me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 136/1 prot., datë

27.01.2023, dhe nr. 136/3 prot., datë 02.02.2023, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 25, datë 09.02.2023, u vendos të zgjatej deri në 30 (tridhjetë) ditë afati për marrjen e vendimit përfundimtar për aplikimin e shoqërisë “SUN AVENUE” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); Shtojcën 1, Shtojcën 1A dhe Shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (Aneksi A).
- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, sipas përcaktimeve të Aneksit A të Rregullores.
- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “SUN AVENUE” sh.p.k. ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 2.1, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.
- Për sa parashikuar në VNM-në Paraprake në lidhje me zbatimin në terren të projektit dhe duke iu referuar deklaratës së vetë shoqërisë se ajo ka bërë aplikimin përkatës për pajisje me leje ndërtimi nga Bashkia Fier dhe është në pritje të daljes së lejes, vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë që të informojë ERE-n çdo 4 (katër) muaj në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të centralit fotovoltaik, deri në datën 14.04.2024
- ERE, në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet, por duke qenë se nga sa deklaruar nga shoqëria rezulton se jetëgjatësia e pritshme e centralit fotovoltaik është 25 vjet, atëherë ERE kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në dhënien e afatit maksimal për këtë licencë fotovoltaike, deri në 25 vjet.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “SUN AVENUE” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në Povelçë, Bashkia Fier, për një afat 25-vjeçar.

2. Shoqëria të informojë ERE-n çdo 4 (katër) muaj në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të centralit fotovoltaik, deri në datën 14.04.2024.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI